

POETIKA E KRAHASIMIT EROTIK PËR VASHËN NË KËNGËT POPULLORE SHQIPTARE TË DASHURISË

Zymer Neziri

Bankkos-i — BB e Kosovës,
Prishtinë

KUD 891·983:398·83
Punim studimor

Marrë për botim më 15 qershor 1987

Përmbajtje e shkurtër: Figura e krahasimit në këngët popullore shqiptare të dashurisë është shumë e vjetër dhe shumë e përhapur, sidomos për vashën (çikën). Kjo çështje është shtruar sipas rrafsheve krahasuese tokësore — bimore, shpesore-shtazore, të sendeve, atmosferike dhe kozmike, por pa i lënë anash edhe krahasimet shumë të fuqishme të rrafsheve të kombinuara tokë — qiell — tokë.

Hyrje

Çështja e figurave stilistike zë vend me rëndësi të veçantë në mesin e problemeve teorike-letrare të letërsisë sonë gojore, ndërsa krahasimi me siguri bën pjesë në radhën e problemeve që duhet t'i studiojmë në mënyrë të gjithanshme dhe përimtësuese, sepse është njëra ndër figurat më të vjetra, më të shpeshta dhe më të përhapura në këngët tona popullore, e sidomos në këngët e dashurisë. Prandaj, me rëndësi të dorës së parë janë gjurmimi i shtrirjes së tij dhe mundësitë e tij shprehëse për të pasqyruar jetën dhe mjeshtërinë artistike, krahas idealit dhe shijes për të bukurën, për të shfaqur ndjenjat e dashurisë dhe për të përjetuar bukurnë shpirtërore dhe atë fizike të djalit e të vashës.*

Lirika popullore shqiptare, e sidomos këngët e dashurisë, me llojllojshmërinë e figurave stilistike dhe larminë e bollshme të temave të shprehura nëpërmjet pasqyrimin emotiv dhe real, gjatë shekujve u përsos shumë jo vetëm në varg dhe në ritëm, por edhe

* Ky punim është pjesë e një studimi më të gjatë, për poetikën e figurës së krahasimit në këngët popullore shqiptare të dashurisë, i shkruar më 1978, prandaj mungojnë shembujt e këtyre dhejtë vjetëve të fundit.

me shprehje fort tërheqëse figurative dhe me tablo poetike të ndërtuara me mjeshtëri, ku roli i figurës së krahasimit është mjaft i rëndësishëm.

Shtrirja e krahasimit erotik në truallin tonë gjithëkombëtar dhe mosha e tij i kanë bërë vend kësaj figure në radhën e atyre më të vjetrave, më të dalluarave dhe më të përhapurave, si në Veri, ashtu edhe në Jug, sepse ai ka një vazhdimësi të pandërprerë në këngët tona të dashurisë që nga lashtësia e deri më sot, e kjo dëshmohet fare lehtë me këngët e shënuara nga mbledhësit e folklorit tonë gjatë 300 vjetëve të fundit. Kjo figurë jeton edhe sot, si edhe përpara, në bashkëjetesë me figurat e tjera, ndërsa vlerat e saj janë të varura nga pozita e varur ose autonome në kuadër të asaj bashkëjetese figurash.

Duhet hetuar, pra, se si merr frymë kënga jonë e dashurisë për vashën me anë të figurës së krahasimit, i cili është i pazëvendësueshëm si mjet shprehës i ndjenjave, i përjetimit dhe i shijes për të bukurën dhe për të shprehur idealin estetik të popullit tonë: bukurinë fizike dhe shpirtërore në unitet të pandashëm.

A. Rrafshi krahasues tokësor — bimor

E hollë e gatë si landa e plepit

Bota bimore është pjesë përbërëse e rrethit jetësor të njeriut dhe si e tillë është e pandarë prej tij edhe kur gëzohet e dëshpërohet, ose kur dashuron dhe urren. Gëzimi dhe dashuria bëjnë pjesë në intimitetin e njeriut, në atë pjesë të jetës që i takon vetëm atij, pra këto të dyja së bashku pasqyrohen nëpërmjet të lirizmit. Ndjenja erotike kërkon gjithmonë një rrafsh mbështetjeje. E rrafshi tokësor duket si më i afërmi, më i qëndrueshmi, por edhe më i sigurti. Andaj, mundësitë krahasuese janë më të mëdha, dhe ky lirizëm erotik tokësor gjithnjë kërkon aty objekt krahasues për shprehjen e ndjenjave suptile ndaj vashës, por edhe më i sigurti. Andaj, mundësitë krahasuese janë më të mëdha, dhe ky lirizëm erotik tokësor gjithnjë kërkon aty objekt krahasues për shprehjen e ndjenjave suptile ndaj vashës, por edhe për shprehjen e shijes estete për bukurinë e saj. Kjo shije është formuar gjatë shekujve, e mbi këtë rrafsh tradicional ka vazhduar transformimi dhe përsosja e saj.

Ambienti rural është kudo i pranishëm. Jeta në vërri dhe në malësi ia kanë dhënë vulën e vet lirikës sonë erotike, sepse në gjirin e tyre është krijuar vargu subtil për bukurinë fizike dhe shpirtërore të vashës, qoftë në ultësira ose në bjeshkë. Për të vënë më mirë dhe më fuqishëm në spikamë bukurinë e vashës, djali këtë e krahason, bie fjala, me trupin e plepit. Hollësia dhe gjatësia e vashës janë veçori dalluese që ai dëshiron më së shumti

t'i vërë në pah. Këto dy veçori karakteristike janë pjesë përbërëse të shijes dhe ndër sinonimet e bukurisë trupore. Ndërkaq, deri diku, i kundërvihen shijes tjetërfare që paraqitet aty-këtu në lirikën tonë erotike: ajo është e bukur, por edhe vithegjerë etj.. Paraqitja e trashësisë, e cila i kundërvihet hollësisë, është e lidhur me dobinë jetësore dhe njëherazi është dalje nga binarët e bukurisë suptile, do të thoshin pa të drejtë estetët stërhollues.

Në variantin kosovar ajo është, pra, „E hollë e gatë si landa e plepit”.¹ Është ky krahasim i qëlluar fort për dy veçoritë karakteristike të jashtme të trupit të vashës. Pra, nga gjatësia dhe hollësia e shtatit të trupit të saj pasqyrohet vetë bukuria. E plepi është sinonim jo vetëm i gjatësisë, dhe i hollësisë, proporcionalisht të ndërtuara, por edhe objekt i përshtatshëm nga bota bimore për shprehjen e ndjenjave lirike suplime të djalit ndaj vashës. Në këtë krahasim dhe në tablonë poetike paraqitet utilitarja, mirëpo ajo është tejperiferike dhe vetëm mund të hetohet si e dëshiruar, por qëndron megjithatë e fshehur. Fundja, dihet fare mirë se utilitarja dhe estetja, nëse qëndrojnë së bashku, asgjë nuk prishin në tërësinë e shfaqjes sublime estete në një tablo poetike, por as edhe në jetën e përdisthme. Kjo është e vërteta artistike, estete dhe jetësore e shprehur edhe në figurën krahasuese erotike—lirike, dhe edhe njëherë e hedh poshtë botëkuptimin estet idealist se utilitarja dhe estetja nuk e kanë vendin pranë njëra-tjetrës, sepse, sipas tij, aty ku paraqitet utilitarja, bukuria është e luhatshme dhe e paqëndrueshme.

Pra, vasha është si plepi, si trupi i tij, dhe krahasimi që e shpreh këtë ndjenjë të djalit është pjesë përbërëse e pamjes së plotë poetike që krijohet në këtë këngë. Megjithatë, edhe vetëm ky krahasim krijon një tablo të veçantë, një tablo në miniaturë, e cila i zgjon asociacionet e së bukurës. Një fuqi të tillë shprehëse e ka edhe krahasimi: „E rritun e hollë si pjergull lastar”.² Krahasimi i vashës me pjergullën është i qëlluar. Dhe, pjergulla tani është edhe më afër nevojave reale të jetës së njeriut, sesa plepi. Këtu kemi një utilitare më të afërt se te vasha e krahasuar me plepin, mirëpo plotëria e shijes estete deri diku këtu duket më e ndrydhur. Edhe pjergulla është e bukur, por plepi i përgjigjet më shumë shtatit dhe bukurisë fizike. Krahasimi me plepin ose me pjergullën është real, pra, vërtetësia e jetës buron nga vetë rrethi ku gjallëron njeriu ynë. Nga ky ambient ai frymëzohet prej bukurisë, e atë bukuri ai e përjeton. Ky përjetim domosdo është i lidhur ngushtë me vetë jetën në këtë ambient jetësor. Ai aty jeton dhe nga kjo jetë kërkon diç më shumë; kjo është detyrë e përhershme e tij ndaj vetvetes dhe ndaj të tjerëve që vijnë pas

¹ *Visaret e Kombit, IV.* — Botim i Ministrisë së Arsimit. Shtëpia botonjëse „Kristo Luarasi”, Tiranë 1939, f. 245, k. 56, v. 3.

² *Po aty*, f. 253; k. 69, v. 4.

tij, për ta humanizuar edhe më tej jetën. Andaj, njësimi i njeriut me rrethin e tij është një bukuri në veçanti dhe një dëshirë që përpiket gjithnjë ta realizojë për ta shijuar edhe më shumë jetën.

Vasha e rritur, kur shkëlqen bukuria nga trupi i saj, duhet të duket edhe më e bukur sesa që është. Kjo është dëshira e trimit, sepse ai dëshiron që ajo „të lulëzojë si molla”.³ Ai përpiket ta realizojë këtë dëshirë edhe nëpërmjet rrugëve të pamundshme, por megjithatë ka guxim e besim se çdo gjë është e mundshme, andaj nëpërmjet personifikimit të apostrofuar i drejtohet edhe malit që t'i ndihmojë, sepse vasha duke u stolitur në dritën e hënës ndoshta do t'i gjasojë asaj. Pason lulëzimi, e ai dëshiron që ky lulëzim i mollës t'i gjasojë vashës. Molla dhe vasha tani identifikohen njëra me tjetrën. Por, trimi ia ka lakmi mollës lulëzimin. Ai këtë lulëzim nuk e do veç për vete, por dëshiron që t'ia dhurojë vashës që e do aq shumë. Ajo do të duket edhe më e bukur, por krahasimi në këtë këngë nuk ka ndonjë bukuri veçuese. Megjithatë, bukuria vetvetiu buron nga kjo figurë, sepse veç zgjon asociacione për një përjetim estet të bukurisë shpirtërore dhe fizike të vashës. Ky krahasim njëherazi e ngre edhe tensionin erotik, i cili është në rritje e sipër, nëse parafytyrohet tabloja e plotë poetike që krijohet me tërësinë e vargjeve të këngës.

Krahasimi „Morje mira kuq si moll”⁴ është thurur nga djali i ndezur që digjet, ndërsa ajo ngurron dhe u frikësohet fjalëve... Ky krahasim e fuqizon qëndrimin e djalit për ta bindur atë, por si figurë është e mangët për paraqitjen e kësaj gjendje shpirtërore të djalit. Në këngën „Morje mira kuq si molla”,⁵ po ashtu e Hasanajt, fillon vargu i parë me këtë krahasim, e pastaj pason nëma e djelit që s'e mori për grua. Kënga mbyllet prapë me krahasim, i cili i zbulon ndjenjat e pastra të djalit. Ai e do edhe më atë vashë, se bukuria e saj është fort tërheqëse, ndërsa krahasimi është fuqizuar sidomos me pjesën e vet të dytë: me *ngjyrën e kuqe*, e cila bëhet ndërlidhëse e zgjedhur me shije për objektin e krahasuar dhe atë krahasues.

Vasha dhe trimi takohen. Ai këtë takim e quan *mejdani*. Ajo, „me hoja në dhëmbë” duket: „po si një manare”.⁶ Vasha tani krahasohet me manaren, e për këtë e frymëzojnë pjesët e trupit të saj, e sidomos dhëmbët. E tërë kjo përpjekje në ndërtimin e vargut bëhet që vasha të duket sa më e bukur, andaj figura e

³ *Visaret e Kombit, III*. — Botim i Komisionit të 25-vjetorit të Vetëqeverimit. Shtypshkronja „Nikaj”, Tiranë 1937, f. 75, k. 125, v. 4.

⁴ Gjergj Hasanaj, *Malësori këndon*. Këngë popullore nga shqiptarët në RS të Malit të Zi. Cetinë 1971, f. 464, v. 14 i këngës „Morje vogël moj sherbesë”.

⁵ *Po aty*, f. 467, v. 1 i këngës: „Morje mira kuq si molla”.

⁶ *Visaret, III*, f. 288, k. 109, v. 19.

krahasimit këtu duket si e domosdoshme për ta krahasuar atë me diçka tjetër, por që është e afërt me njerëzoren dhe me ndjenjat suptile.

Në një këngë të Reinholdit, pas çdo krahasimi, pason kërkesa e djalit. Kërkesa e tij është: për ta puthur vashën. Së pari në bark e pastaj në ballë. Edhe në këngë të tjera kësofare ndër ne gjenden shembuj të bollshëm se kërkesat e djalit fillojnë diku kah shtati, ngrihen kah koka, zbresin kah gjoksi etj. Kënga e Reinholdit është mjaft e vjetër. Është, pra, karakteristike për kërkesat e dikurshme të shqiptarit për shtryerjen e emocioneve erotike, të cilat nuk ndryshojnë shumë edhe në këngët e ngjashme të mëvonshme ndër ne.⁷ Krahasimi u prin kërkesave të djalit për ta puthur vashën „e bardhë si bumbak”. Bardhësia e fytyrës së saj është veçori e pamjes fizike, por edhe plotësim dhe qartësim i shijes estete në pamjen poetike. Bardhësia dhe puthja janë unitet i bukurisë dhe i përjetësimit erotik. Ky krahasim prijës e ngre edhe më tensionin erotik. Pra, krahasimi zbulon një pjesë të historisë së emocioneve erotike nacionale, ndonëse kërkesat dhe shfryerja e emocioneve erotike nuk janë gjithnjë të njëjta, në çdo kohë dhe te çdo popull.

Në vargun e tretë të këngës së përmendur pason prapë krahasimi: „Mor, je e bukurë si dardhë”,⁸ për të plotësuar edhe një kërkesë të djalit. Mundësia krahasuese prapë duket më e afërt me rrafshin tokësor, sepse pema dhe vasha janë në afëri me njëra-tjetrën. Bukuria e dardhës i gjason asaj të vashës, por edhe shija e dardhës, më shumë sesa forma e saj, vjen e zë vend në këtë krahasim. Në këngën e shënuar prej Mitkos, dëshira e djalit bëhet shumë e fuqishme; ai e do vashën e tërë: „Të të puthë, e të të dua / të të shtryth posi limua”.⁹ Kjo bukuri mahnitëse e vashës e ngre aq shumë tensionin erotik të djalit, sa ky dëshiron që atë ta shtrydhë *posi limua*. Utilitarja erotike, e shprehur me anë të këtij krahasimi, po edhe në tërë tablonë poetike, është e lidhur ngushtë me ndjenjat dhe me emocionet, të cilat lidhen me vetë shijen estete të krijimit të këtyre poetik për bukurinë e vashës dhe për përjetimin e trimit. Në veçanti vlen të theksohet se nga ky krahasim hetohet fare mirë edhe norma morale e shprehjes poetik. Brenda kufijve të saj vepron, pra, këngëtari popullor. Pornotablote në lirikën tonë erotike janë të rralla, po edhe herë-herë kur ngrenë krye, ato disi fashiten në vetë erotizmin e tab-

⁷ Carol H. Th. Reinhold, *Noctes Pelasgicae vel symbolae ad cognoscendas Dialectos Graeciae Pelasgicas*. Typis Sophoclis Garbola, Athinë 1855; në: *Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar*, I. Tiranë 1961, f. 97, k. 11, v. 1.

⁸ *Po aty*, f. 97, k. 11, v. 3.

⁹ Thimi Mitko, *Alvaniqi Melissa (Bëleta Shqypëtare)*, Aleksandri 1878; në MHFSH, II Tiranë 1961, f. 57, k. 17, v. 6 e 7.

losë poetike. Etika dhe morali, si elemente shumë të rëndësishme të karakterit, janë ato të cilave gati në çdo rast u nënshtrohen edhe ato tablo poetike që kanë një tension fort të ngritur emocional-erotik.

Djali gjithnjë do të digjet për vashën, edhe atëherë kur kufijtë e takimit i afrohen të pamundshmes. Dashuria e tij duket përherë njerëzore, plot ndjenja dhe me shumë optimizëm jetësor, madje edhe atëherë kur realizimi i saj bëhet fort i vështirë. Ai, i shqetësuar, digjet flakë për vashën *zog i shkruar*. Vërtet, ai kurrësi nuk e humb ndjenjën e përjetimit të së bukurës edhe në atë gjendje të vështirë shqetësuese shpirtërore, sepse vashë për të mbetet gjithnjë: „zog i shkruar si zambak”.¹⁰ Krahasimi i përmendur është fort i qëlluar, por edhe mjaft i humanizuar si për shprehjen e ndjenjave, ashtu edhe për tensionin erotik. Ai pason menjëherë pas gjendjes shpirtërore tejet shqetësuese, sepse ky shqetësim e djeg djalin. E djeg atje ku i dhemb më së shumti. Por, zemra e djalit, megjithëkëtë, është e fortë dhe duron për atë *zog të shkruar si zambak*, që mund të fluturojë lehtë e shpejt, të ikë larg, por edhe të kthehet po ashtu lehtë dhe shpejt. Krahasimi i përgjigjet mirë vargut paraardhës, i cili i zgjon asociacionet e dhimbjes, të shqetësimit; të një dashurie të zjarrtë e të flaktë. E ajo, *si zambak*, pakëz ia flladit zemrën e djegur. Ai është këmbëngulës dhe i paluhatshëm; e duron këtë gjendje në shpirt, por, megjithatë, nuk heq dorë. Dashuria është e sinqertë, e përjetuar thellë për vashën *si zambak*, nëpërmjet figurës së krahasimit, të transponuar artistikisht dhe me mjeshtëri.

Kënga „Tundu, bejkë e bardhë, tundu” u përhap pas Festivalit Folklorik Kombëtar, më 1973 në Gjirokastër, por rrënjët i ka më të thella historikisht në folklorin tonë: „Kur merr ujë te burimi, / më dukesh si lule prilli”.¹¹ Krahasimi është fort tërheqës dhe qëndron diku kah mesi i këngës, si dhe duket se është këtu i vetmi për atë *bejkë* në ambientin blegtoral. Pason marrja e ujit në burim, dhe mu këtu krahasimi e hap këtë pjesë të bukur të tablosë së dytë, ndërsa në të tretën kopeja kullot, çobani i biçycles (dyjares).

Ky krahasim është i transformuar ashtu si edhe vetë kënga, e transformimet e këtilla janë prore të pranishme në folklor, prandaj njëherazi transformohet edhe vetë figura poetike brenda këtyre ndryshimeve gjatë historisë.

¹⁰ *Visaret, III*, f. 102—103, k. 185, v. 18.

¹¹ Arsen Mustaqi, *Këngë popullore lirike*. Shtëpia Botuese e Librit Shkollor, Tiranë 1977, f. 63, v. 14 i këngës „Tundu, bejkë e bardhë tundu”.

B. Rrafshi krahasues tokësor—shpesor e shtazor

Zanin si bilbil e t'ecurit thëllënzë

Bota e gjallesave është një botë më vete. Aty, në mesin e tyre, e ka vendin edhe njeriu si homo sapiens. Varësia reciproke ka qenë gjithnjë e pranishme, dhe mu kjo prani pasqyrohet edhe në poetikën folklorike. Identifikimi i njeriut me shtazët, me shpesët, ose me bishat e malit, prore bëhet që të vihen në spikamë ato veçori karakteristike të tyre që i përgjigjen edhe njeriut, por në rrafshin estetik dhe jetësor. Lakmia është e pranishme dhe anon kah ato veçori karakteristike fizike dhe emocionale që i kanë hije njeriut, pra, që i kanë hije vashës. Pr, jo vetëm për këto, se edhe vetitë e këqija herë-herë përdoren për t'i vënë në pah vetitë e ngjashme të njerëzve. Ja, bie fjala, ky është një kthim i përhershëm i njeriut kah bota shtazore, kah ajo botë që e afron fort dhe që në të njëjtën kohë qëndrojnë shumë larg njëri-tjetrit. Megjithëkëtë, krahasimet janë të mundshme dhe reale, sepse si të tilla i takojnë rrafshit tokësor, por edhe pse më së shumti i përgjigjen botës së njeriut: zëri, fuqia trupore dhe forma e trupit, ecja, qëndrimi, ngjyra, emocionet etj.. Ndonëse këto krahasime nuk janë kurrë të mundshme, megjithatë ato i gjasojnë realitetit të botës së njeriut, prandaj edhe janë afërsisht të mundshme. Veçanërisht në rrafshin poetik, ato krijojnë kolorite të ndryshme në pamjet poetike, ndërsa prania e krahasimeve të këtilla nga bota shtazore nuk e rëndon vargun, po përkundrazi e bën më të afërt për ne. Shija estete dhe ngjyra emocionale janë shumë më të kapshme, sepse qëndrojnë mbi një rrafsh krahasues, që është shumë i afërt me njeriun.

1. Krahasimi i vashës me bilbilin është rast i shpeshtë, si domos i zërit të saj. Bilbili është i shquar për zërin e tij të bukur, andaj djali këtë zë të tij do ta krahasojë me zërin e mikes. Në këngën e Dozonit, krahasimi në vargun e katërt e shpalos pamjen poetike për bukurinë fizike të vashës, por jo edhe për ngjyrën e qartë emocionale të ndjenjave të djalit: „Zënë si bilbil e a'ecurit thëllënzë”.¹² Ajo u martua. Ajo tani e tutje do t'i takojë tjetërkujt. Shprehja metaforike e kësaj kënge është shumë e pasur. Ajo fillon me botën e shpesëve, e përfundon me atë kozmike: me yllin e hënën. Nga krahasimi hetohet dhimbja e djalit që ajo u

¹² A. Dozon, *Manuel de la langue chkipe au albanaise*, Paris 1879; në MHFSH, I, f. 312, k. 23, v. 4.

bë nuse e tjetërkujt: „Gjynah perëndinë me kë fjete prëmë”.¹³ Krahasimi e qet në sipërfaqe dashurinë e tij ndaj asaj. Ai nuk është i zemëruar në të. Ndoshta është i dëshpëruar, dhe për këtë e fajëson edhe vetveten për martesën e saj. Ai ende e do zërin e saj, e do të ecurit e saj. Krahasimi në vargun e katërt është tradicional. Në këtë rast ai nuk mund të konsiderohet strumbullar poetik, por vetëm si mjet për shpalosje poetike. Sidoqoftë, ai është freskim i tablosë dhe njëkohësisht sjell jo vetëm ngjyrë emocionale, por edhe një optimizëm të matur shpirtëror dhe erotik. Lirizmi tërheq pas vetes edhe ngazëllimin, por po ashtu të matur për një dashuri që s’është fatlume. Kryesorja, aty nuk është e pranishme nota pesimiste, e kjo është fort e rëndësishme për vitalitetin shpirtëror dhe poetik në vargun tonë lirik.

Ata i ndan vetëm një sokak. Janë shumë afër, por edhe shumë larg njëri-tjetrit. Bukuria e saj është mahnitëse. Ai do ta takojë, por mundësitë i ka tepër të kufizuara. I mbetet vetëm meditimi, sepse vasha nuk gëzon liri njerëzore: „Rreth e rreth të kanë rrethue, / si bylbyli në pranverë; / a s’ke krahë me fluturue, / me t’i pa syt njiherë?!”¹⁴ Djali, nëpërmjet vargut, e kërkon të pamundshmen nga vasha, sepse beson se ajo është *si yll*, po edhe *si bylbyl*, andaj duhet të ketë edhe krahë për të fluturuar, për të ikur nga kafazi. Krahasimi në vargun e 14 shpreh një gjendje fort emocionuese të djalit për pamundësitë realizuese të lirisë së vashës. Këtë gjendje e përjetojnë që të dy, andaj tensioni vjen e rritet, kurse pamja poetike del me një kolorit fort prekës për atë gjendje mjeruese shoqërore të femrës dhe të pozitës së saj. Raporti njeri-njeriu është vënë këtu në spikamë nëpërmjet krahasimit, duke shprehur marrëdhënie të caktuara patriarkale e konservatore të familjes sonë në kushte të caktuara sociale dhe shoqërore. Fundja, këto vargje, bashkë me figurën e krahasimit të vajzës me bilbilin, zbulojnë një pjesë të historikut të pozitës së pabarabartë të femrës në një periudhë kohore historike. Hallet e djalit për ta takuar vashën nuk kanë fund. Ajo është: „E mirë boll, e bardhë si pllumi”.¹⁵ Vashën dhe pëllumbin i identifikon bardhësia, e mu kjo bardhësi është shprehje e shijes estete për të bukurën. Ky krahasim i prin kësaj kënge tetëvargjeshe dhe e shpalos tablonë poetike: vashën, bukurinë e saj dhe ambientin malor — bjeshkën. Bardhësia i përgjigjet vashës dhe ambientit. Mundësitë për t’u takuar djali me vashën janë shumë të mëdha, sepse këto janë të hapura nga vetë ambienti rural. Figura e krahasimit këtu është shprehëse jo vetëm e bukurisë dhe e shi-

¹³ *Po aty*, f. 312, k. 23, v. 11.

¹⁴ Instituti i Folklorit, *Këngë popullore dashurie*, Tiranë 1965, f. 43, v. 13—16.

¹⁵ Instituti Albanologjik i Prishtinës, *Këngë dashurie, I*, (dorëshkrim), Prishtinë 1978, k. 1. v. 1.

jes estete, por njëherazi edhe e lirisë së takimit dhe qëndron në antitezë me krahasimin paraprijës sa i përketë raportit shoqëror dhe pozitës së femrës sonë, qoftë si *bilbil* i mbyllur apo si *pëllumb* i lirë.

Nuk janë të rralla rastet kur djali, nga ngazëllimi për vashën dhe për bukurinë e saj, kërkon mundësi krahasuese brendapërbrenda botës së shpesëve. Vasha, sipas djalit, i gjason pëllumbit, por edhe pëllumbi e vasha i gjasojnë njëri-tjetrit. Mikja e tij është e vogël, andaj ai atë e krahason: „E vogël si zok pëllumbi”.¹⁶ Djali është fort i lumtur për miken që e ka, ndërsa krahasimi këtu është një shfryerje e këtij gëzimi, e ngazëllimit dhe sillet diku kah rrafshi i raportit krahasues uxor, për t’u kthyer pastaj kah toka dhe ajri. Mundësitë e këtij krahasimi janë mjaft të bollshme për të shprehur shijen e hollë për bukurinë e vashës. Madhësia e trupit të saj krahasohet me atë të zogut të pëllumbit, pra, ajo është e vogël, por e bukur, dhe ky asociacion e shpalos pamjen poetike me sukses.

Pos bilbilit dhe pëllumbit, të shpeshta janë rastet kur ajo krahasohet me zogun: „Krahjeshile posi zok”.¹⁷ Pos shprehjes poetike, me theks erotik, ky krahasim duhet të përmendet sidomos për fijen transmetuese *posi*, e cila është më e rrallë sesa fija tjetër *si*. Këto dy fije transmetuese janë tradicionale në lirikën tonë popullore.

Krahasimeve nga bota shpesore shpesh u shtohet edhe thëllëza e krahasuar me vashën. Ajo, bie fjala, në vargun e Mitkos duket kështu: „Jelek — kuqeje — veshurë / Si thëllënxa sokëllinje”.¹⁸ Thëllëzë i duket djalit vasha, sepse ato njëra-tjetrës i gjasojnë; ajo *sokëllin* si thëllëzë, andaj ai e do shumë atë *jelek-kuqe*. Funkcioni poetik i këtij krahasimi është efektiv. Vasha të zgjon asociacionin e një zogu që s’është si të tjerët. Ajo është thëllëzë që zbret bregut. Ajo është e lehtë, e shpejtë. Në atë lehtësi dhe shpejtësi të saj duket një pamje e bukur që rritet nga ngjyra e kuqe e jelekut. Pra, krahasimi këtu kryen jo vetëm një funksion poetik, por edhe estetik, sepse thëllëza është vetë lehtësia, shpejtësia dhe gracioziteti i vashës së veshur në të kuqe. Gati e njëjta gjë shprehet edhe në vargun e këngës tjetër të Mitkos, nga *Dorëshkrimi i Pragës*: „Tatëpjetë malit, kur më sbret si fluturë”.¹⁹ Maria është si flutura, e djali e do Marinë e bukur, të paputhur dhe *meskëputur*. Krahasimi *si flutur* e zgjon asociacionin e bukurisë, por edhe ngre tensionin poetik, se flutura është e shpejtë,

¹⁶ Spiro Dine, *Valët e detit*. Shtypur në shtypshkronjën shqipe „Mbrothësia”, Sofje 1908; në: MHFSH, III, Tiranë 1962, f. 108, k. 59, v. 2.

¹⁷ *Po aty*, f. 100, k. 35, v. 2.

¹⁸ Th. Mitko, BSH; në: MHFSH, II, f. 91, k. 68, v. 2 e 3.

¹⁹ Thimi Mitko, *Dorëshkrimi i Pragës*; në: MHFSH, II, f. 206, k. 38, v. 1.

e lehtë, e bukur, me plot dinamizëm jetësor, ashtu siç është edhe vetë vasha. Krahasimi u prin këtyre vargjeve të kësaj kënge dhe duket strumbullar i tyre, sepse ky jo vetëm që e zbulon pamjen poetike, por mbetet pikë qendrore e kësaj tabloje të ndërtuar me një mjeshtëri për lakmi, për atë flutur belhollë që s'është lehtë t'i puthen faqet. E djali, sikur do të kënaqej që vetëm ta shohë në dritare, sepse e di se flutura nuk zihet lehtë. Krahasimi ka një funksion të pazëvendësueshëm poetik në këtë këngë.

Në një këngë tjetër të Thimi Mitkos, po ashtu në *Dorëshkrimin e Pragës*, vasha krahasohet me sorkadhen: „Qafëgjatë si zor-kadhe”.²⁰ Është ky një krahasim tradicional i rrafshit tokësor të botës së shpeshëve, i ndërtuar me një shije estete mjaft të hollë. Ky krahasim është pjesë përbërëse e pamjes poetike, ku paraqitet bukuria e vashës me mjaft mjeshtëri artistike. Po në të njëjtën këngë, në vargun pasues (i katërti), vasha krahasohet me kunadhen: „Këmbëshkurtër si kunadhe”.²¹ Kjo ka të bëjë me lakminë e veçorive karakteristike të kunadhes, sorkadhes, fluturës, zogut, pëllumbit, bilbilit, thëllëzës, etj., e mu kjo e plotëson dhe e bën edhe më të plotë dhe më suptile shijen estete në krijimet tona lirike. Kjo shije suptilizohet edhe më shumë, kur kihet parasysht fakti se kjo është një përpjekje e pandërprerë për njerëzimin e jetës në tërësi dhe në veçanti të botës shtazore. Në rrafshin teorik, në të dy shembujt e fundit, vërehet një uniformitet i ndërtimit të krahasimit, i cili përbëhet vetëm prej epitetit dhe prej objektit krahasues. Epiteti është vetë objekti i krahasuar, pra vasha. Fija transmetuese është tradicionale. Vargu i këtillë mund të konsiderohet më i thjeshti në ndërtimet e këtilla, por duhet pasur parasysht thjeshtësinë edhe më të madhe të vargut të ngjashëm me këtë, kur objekti i krahasuar nuk është i zëvendësuar me epitet ose me atribut.

2. Në këngët tona erotike krahasimit i paraprin edhe personifikimi dhe apostrofa, si bie fjala në këtë këngë të G. Meyerit, e shënuar prej Mitkos: „Ti moi hëna, që ke rarë. / S'më pe lulen ku ka shtruarë? / N'datë qoshk me dy-tri shkallë, / Është shtrirurë si ngjalë”.²² Figura e krahasimit, këtu, është plotësim dhe rumbullakim i pamjes poetike. Krahasimi për veshën e shtrirë si ngjalë, e zbërthen edhe më mirë tablonë, sepse është natë, hëna ka dalë, kurse trimin nuk e zë gjumi. Ai e fillon bisedën me vashën, me ndërmjetësimin e hënës. Vërtet, djali është larg hënës, pra, edhe larg vashës, por megjithatë kërkon ndihmë nga hëna shumë e largët që t'i afrohet vashës. Krahasimit i prijnë personifikimi dhe apostrofa, për të shprehur pamundësinë e takimit të

²⁰ *Po aty*, f. 209, k. 6, v. 3.

²¹ *Po aty*, f. 209, k. 6, v. 4.

²² Gustav Meyer, *Albanesische Studien*, VI, Vjenë 1897; në: MHFSH, II, f. 297, k. 24, v. 4—7.

dy të rinjve, që më afër e kanë hënën se njëri-tjetrin! Hëna del këtu si ndërmjetësuese dhe e zëvendëson njeriun. Krahas mundimeve shpirtërore, krahasimi nxjerr në sipërfaqe bukurinë fizike të vashës, sidomos trupin *si ngjalë*. Ky krahasim ka një mbështetje fort të qëndrueshme në rrafshin estet, sepse i zgjon asociacionet e një bukurie të vijës gjarpërore, e cila ndër shekuj është konsideruar si përsosmëri e formës estete të së bukurës. E nga ky krahasim i Meyerit e hetojmë bukurinë e trupit, një bukuri të përsosur, e cila, e krahasuar me objektin krahasues, prapë duket se është varg popullor i ndërtuar me një shije të hollë poetike për të bukurën. Aty, krahas bukurisë, qëndron edhe pamundësia realizuese shpirtërore dhe më tepër fizike e djalit me vashën *si ngjalë*. Edhe në një këngë të Nines e gjejmë një varg të ngjashëm, i cili ndoshta është edhe më i afërt, më i kapshëm, i ndërtuar shumë më lehtë, pa ndërmjetësimin e domosdoshëm të figurave të tjera: „Kam mike un’i lumi... / Të hollë si ngjalë lumi”.²³ Edhe këtij krahasimi nuk i mungon po ashtu shija e hollë estete për të bukurën.

Në një vazhdimësi të këtillë, kah krahasimet e ngjashme, të cilat shprehin të njëjtën vijë të shijes estete, është edhe kënga e Strugës: „O midis — holla porsi xharpen-o”.²⁴ Ky krahasim i prin kësaj kënge të shkurtër, e cila luhet edhe si valle dhe është shënuar në Veleshtë, për vashën me trup si gjarpër, të hollë, elastik, të lëvizshëm dhe fort të gjallë. Dinamizmi jetësor dhe asociacionet e tjera që zgjon ky krahasim, edhe në rrafshin e paramenduar vizuel, shprehin një bukuri të përsosur të hijeshisë së shtatit. Në një këngë tjetër vasha po ashtu krahasohet me gjarprin, veçanërisht vihet në spikamë sjellja e saj: „Më sjellesh okolla, porsi xharpen”.²⁵ Ndërkaq, në këtë krahasim kemi figurën e realizuar në një kahje tjetërfare, e dimensionuar për realizimin e qëllimit të ndjekur me një agresivitet tërheqës, por edhe rrëqethës. Megjithëkëtë, rrëqethja para bukurisë tërheqëse duket se mënjanohet, ose bëhet dytësore, sepse bukuria dhe ndjenja, që s’frenohen, lehtë janë shkrirë në një.

Krahasimet e këtilla karakteristike, që madje duken si jo të zakonshme në këngët tona kësofare, i gjejmë të shënuara edhe më herët. Kjo dëshmon se prania e gjarprit, si objekt krahasimi për vashën ose për trupin e saj, është tradicional, ndonëse i rrallë. Në vargun e Dozonit ajo krahasohet me nepërkën e malit: „Si nepërkë e malit m’idhërove vuxhunë, / Më zbrite nga mur, më puthe në buzë”.²⁶ Bandillit iu helmua shpirti, por ai nuk është akuzues se ajo si nepërkë e helmoi kur e puthi. Ky helm është

²³ S. Dine, VD; në: MHFSH, III, f. 108, k. 59, v. 1 e 3.

²⁴ Shpresë Tuda, *Jeta e re*, nr. 2—1971, f. 301, v. 1.

²⁵ IAP, KD, I, k. 405, v. 2.

²⁶ A. Dozon, *Manuel...*; në: MHFSH, I, f. 307, k. 2.

vetë ndjenja shumë e fuqishme erotike që zgjoi ajo tek ai, e tani ky helmuar është nga helmi i nektarit të dashurisë. Vasha si nëpërkë zgjon asociacione të ftohjes shpirtërore, por edhe të ngrohjes dhe të ndezjes së zjarrit erotik. Ajo është gjarpër, një gjarpër fort helmues dhe shërues i shpirtit, vija trupore e të cilit përputhet me bukurinë e përsosur.

3. Edhe shpesët shtëpiake shpesh shërbejnë si objekte krahasuese në lirikën tonë erotike, por nuk janë rastet aq të shpeshta të ndërtimit të pamjeve poetike me krahasimet e këtilla. Një përfundim i këtillë ka mbështetje reale dhe logjike, por megjithëkëtë, gjejmë aty-këtu edhe këngë dashurie me krahasime të rrafshit të përmendur, si në këto vargje të Mitkos: „Varur gjerdani në gushët me rrathë/ Kur më del te dera, e bardhë si patë”.²⁷ Është vënë këtu në spikamë bardhësia e pendlave të patës, por krahasimi këtu nuk është strumbullar, por vetëm në funksion të vargut paraardhës. Madje si i tillë nuk zgjon asociacione, e nëse po, atëherë ato kanë një intensitet jo të fuqishëm. Edhe në një këngë arbëreshe vasha krahasohet me patën: „More je e bukur si papie”,²⁸ duke ia vënë në spikamë vetë bukurinë e saj. Krahasimi i vashës me patën, në këtë këngë, duket i ndërtuar pa zor, më lirisht funksionon si varg në tablonë poetike dhe më shumë duket në funksion të vetvetes sesa të vargjeve të tjera. Intensiteti asociativ është më i fuqishëm, e po ashtu shija estete është më e hollë. Nuk janë raste të rralla kur vasha krahasohet me objekte e frymorë që nuk i përgjigjen asaj, pra nuk e kryejnë funksionin e kërkesave estete, por më tepër kryejnë një funksion statik, pa dinamizëm jetësor, e madje sjellin një notë të tepruar ritmike formale, sa vetëm e vetëm që vargjet të kenë përputhje njëra me tjetrën. Varg i tillë mund të konsiderohet ai i Mitkos, për bardhësinë e vashës. Mungesat e shfaqura në të gdhendurit e vargut popullor lirik janë shfaqje të pashmangshme, të vrojtuar nga rrafshi teorik dhe estet, ndërsa shkaqet dhe arsyet janë të ndryshme dhe të shumta.

4. Ambienti rural bën kushtëzime jo vetëm sociale dhe ekonomike për njeriun që gjallon në të, por këto pasqyrohen edhe në sferën e shijes estete për të bukurën. Këto kushtëzime krahasuese janë aq ngushtë të lidhura, sa formimi i shijes analoge estete për të bukurën duket fort i natyrshëm në një ambient të atillë. Vasha e atij mjedis jetësor duhet t’u përgjigjet kërkesave jetësore, e këto i kushtëzojnë edhe kërkesat estete — krahasuese, e sidomos shijen për të bukurën. Ajo është e veshur dhe e ngjeshur me çdo gjë që i duhet një gruaje për t’u dukur jo vetëm sa më e bukur, por edhe më e zonja e jetës për punë dhe për jetesë, si bie fjala në vargjet e Dines: „Po vjen mikja monopatit, / Me

²⁷ Th. Mitko, DP; në: MHFSH, II, f. 201, k. 20, v. 1 e 2.

²⁸ *Visaret*, IV, f. 352, k. 7, v. 6.

takëme si të atit”.²⁹ Rrafshi krahasues është tokësor i ambientit fshatar, kurse utilitarja duket tërthorazi e pranishme. Pamja e jashtme e mikes është si ajo e atit, e ati ka një bukuri në veçanti në mesin e kafshëve të tjera. Krahasimi është i qëlluar. Ai zgjon asociacione të një bukurie të fuqishme, e me një dinamizëm të madh jetësor e dëshmon shijen tonë estete tradicionale për bukurinë fizike të vashës. Nga ky krahasim reflektohet fuqia, krahas bukurisë. Këto janë kërkesa themelore jetësore, sepse bukuria do të dukej e mangët, pa fuqi jetësore, pa dinamizëm. Në një këngë tjetër lirike, djali i thotë asaj: „Çka je majë si ati i shalës?”.³⁰ Majmëria e asaj identifikohet me atë të kalit të shalës, i cili si i tillë ka një bukuri të pashoqe, e mu kjo bukuri i referohet asaj, ndërsa krahasimi është shpalues i pamjes poetike.

Edhe në një këngë tjetër të Dines e gjejmë një krahasim të ngjashëm: „Si mushk’ e mirë me shalë”,³¹ krahasohet vasha, por krahasimet para këtij duken më të qëlluara, pra, të ndërtuar më me mjeshtëri, sepse mushka dhe ati janë e s’janë njësoj. Ati më shumë e përmbush plotësinë e kërkesave estete. Edhe këtu utilitarja është e pranishme, pa fije dyshimi, por jo vetëm kaq. Ajo ka bërë ndikim dominant edhe në përcaktimin e shijes estete dhe në formimin e saj, duke e krahasuar vashën me mushkën. Megjithëkëtë, shija mbetet e palënduar, e paprekur, sepse reflektimi kohor, social dhe ekonomik, janë fort të pranishëm, madje madje mund të themi lirisht se këta janë faktorë dominantë. Krahasimi i vashës me atin ose me mushkën vetëm e plotëson dhe e forcon bindjen se utilitarja bën ndikim të madh në formimin e shijes estete, sepse vetë e dobishmja është pra një pasqyrim i domosdoshëm i rrethanave sociale, shoqërore dhe ekonomike. E shija e këtillë estete është shumë e pasur me ndjenja, shumë më e fuqishme për zgjidhjen e problemeve kyçe të kërkesave të jetës, për zgjimin e asociacioneve të ndryshme, sidomos të atyre erotike, ndërsa koloriti i tablove poetike ka shumë më tepër ngjyra jete dhe optimizëm. Fundja, ky rrafsh teorik e afro problemimin e së bukurës dhe të utilitaires kah humanizimi jo vetëm i vargut popullor lirik, por në përgjithësi në tërë artin poetik. Kur të kihet parasysh kjo e dhënë, shlyhet bindja e gabuar për vrazhdësinë e shijes estete të njerëzve të ambientit rural, ose të lirikës popullore në tërësi.

Edhe në shtresimet e reja lirike popullore ndër ne, ku fillon shija estete të kthehet kah elementet urbane, hetojmë se shkëputja prej ambientit rural nuk bëhet menjëherë, si në këngën për

²⁹ *Visaret*, III, f. 269, k. 104, v. 2 e 3.

³⁰ IAP, KD, I, k. 94, v. 2.

³¹ S. Dine, VD; në: MHFSH, III, f. 95, k. 15, v. 8.

kolonjaren: „Porsi dash manare, rri në fund të odës”.³² Ky varg i prin këngës dhe që në fillim të zgjon asociacionin e pamjes së vashës me një bukuri tradicionale rurale. Krahasimi është me interes, sepse i prin këngës, ndërsa fija transmetuese del në ballë të vargut. Në të parë, ky krahasim duket se është ndërtuar vetëm sa për rimimin e vargjeve, mirëpo vargjet e mëpastajme flasin se funksioni i krahasimit këtu është shumë më i rëndësishëm për ndërtimin e vargjeve të tjera, po edhe të figurave që shquhen nëpër to, veçanërisht epiteti dhe metafora. Në këto vargje shohim përzjerje të elementeve rurale dhe urbane.³³ Këngët e këtilla janë me interes për studim, sepse këtu kemi një bashkëjetesë të ambientit fshatar me atë qytetar, ose ky i fundit është mbishtresë e atij të parit.

Ambienti fshatar që një bazë e fortë mbështetëse me një gjerësi dhe thellësi të madhe për ndërtimin e krahasimit dhe të figurave të tjera në vargun lirik, e sidomos në atë erotik. Objekte krahasuese gjejmë edhe nga mesi i shtazëve — bisha, me të cilat jeton njeriu ynë. „Kenke kuqë si bisha e malit”³⁴ është varg i një kënge shkodrane, nga i cili del një pasqyrë e plotë e ambientit të kësaj rrenese, kurse krahasimi i vashës me të skuqurit e bishës së malit është i qëlluar. Bisha e malit zgjon asociacione që, në aspektin emocional, e shtojnë tensionin erotik për bukurinë fizike të vashës. Ky krahasim më së miri e zbërthen pamjen poetike për fshataren, kurse dinamizmi jetësor është shumë i fuqishëm. Utilitarja dhe e bukura këtu janë shkrirë fort mirë me njëra-tjetrën. Ato janë të harmonizuara, kurse dinamizmi i tensionit erotik në ngritje e krijon një pamje poetike fort tërheqëse, sidomos koloriti i ngjyrës së kuqe.

Në përgjithësi, bota e shpesëve dhe ajo shtazore janë të pranishme në lirikën tonë popullore erotike, ndërsa prania e tyre e shton larminë e objekteve krahasuese për veçoritë shpirtërore të vashës, për cilësitë e saj karakteristike fizike, kryesisht, të cilat vihen pa ndërprerë në spikamë në vargjet kësofare, duke e krahasuar atë me: pëllumbin, bilbilin, zogun, thellëzën, fluturën, sorkadhen, kunadhen, ngjalën, gjarprin, nëpërkën, patën, atin, mushkën, bishën e malit etj..

Larmia krahasuese dhe bollshmëria e gjallesave shtazore e kanë pasuruar dhe e pasurojnë vazhdimisht lirikën tonë popullore. E nëse hetohet mungesa e tyre në krijimet e reja folklorike kësofare, atëherë pa dyshim kemi të bëjmë me largimin e krijuesit popullor nga rrafshi rural tradicional kah ai urban. E kjo rrugë është e pashmangshme, por e para është një mbështetje e fortë,

³² Instituti i Folklorit, *250 këngë popullore dasme*, Tiranë 1966, f. 119, k. 217, v. 1.

³³ *Po aty*, f. 119, k. 217, v. 4.

³⁴ *Visaret*, IV, f. 223, k. 26, v. 23.

shumë e qëndrueshme, andaj do të kultivohet dhe do të ruhet me siguri, sepse njeriu ynë nuk shkëputet dot lehtë nga ambienti rural. Ai është fort i lidhur me tokën dhe aty jeton ku ka jetuar ndër shekuj, andaj edhe vargu i deritashëm do të jetë i pranishëm aty bashkë me krahasimet e ndërtuara në mbështetje në botën e shpesëve dhe të shtazëve, si objekte krahasuese, për identifikimin e jetës dhe të shijes së njeriut tonë.

C. Rrafshi krahasues tokësor me botën e sendeve

Si xhevahire ndriçon

Vasha, është për djalin: „Trëndafil që më shëron / Si xhevahire ndriçon!”³⁵ Ajo e shëron shpirtin e tij, sepse është *si xhevahir* që bën dritë, ngriçon dhe verbon me pamjen e saj. Edhe bukuria e saj është verbuese. Krahasimi i vashës me xhevahirin është fort i qëlluar, por edhe është krahasim i rrallë, sepse nuk u takon frymorëve, veç gjësendeve të çmueshme. Ashtu siç është xhevahiri gur i rrallë dhe fort i çmueshëm, ashtu është e rrallë bukuria e vashës. Zgjimi i parafytyrimit vizuel është bërë prerazi e me një intensitet të fuqishëm. Dinamizmi është eksploziv, pa fashitje. Shpërthen menjëherë dhe ngrihet në një shkallë të lartë. Atje qëndron pa luhatje dhe nuk zbret. Shkëlqimi i bukurisë së vashës të duket se është i gjatë sa vetë shkëlqimi i xhevahirit. Vërtet, në shumë këngë tona lirike popullore përshkruhet bukuria e vashës me një konsideratë të lartë, madje ajo bukuri ka ngjyrimë përmasash të një hijeshie hiperbolike. Pra, në vargun tonë popullor herë-herë del krahasimi si figurë e ndërtuar mbi një rrafsh joreal; i tejkalon caqet e mundësive jetësore të realitetit dhe ngrihet kah e pamundshmja. E mu kjo gjë këtë figurë e bën interesante dhe mjaft të përhapur, sepse ndërtohet fare thjeshtë, ndërsa mundësitë krahasuese janë të pakufizuara. Edhe kur mungon rrafshi real, megjithatë aty është e pranishme realja, sepse aty është vasha e bukur, e bukuria e saj duhet të përshkruhet dhe të krahasohet me mjete të atilla krahasuese që janë larg ose afër baras vlerës së bukurisë së saj. Fundja, kjo është liri poetike.

Në një këngë tjetër të Spiro Dines gjejmë po ashtu edhe një krahasim të ngjashëm si ky i mëparshmi: „Vet 'e bardh' e gërshet degë / E bukur si xhevahir”.³⁶ Këto dy krahasime janë afërsisht të njëjta, por në të parin vihet në pah ndriçimi i vashës, i cili të jep të nënkuptosh se është fjala për bukurinë e saj, ndërsa në të dytin përmendet drejtpërsëdrejti bukuria e saj dhe, si e tillë,

³⁵ S. Dine, VD; në: Visaret, III, f. 267, k. 101, v. 6 e 7.

³⁶ S. Dine, VD; në: MHFSH, III, f. 111, k. 71, v. 3 e 4.

krahasohet me xhevahirin. Ndërkaq, në të parin prin fija transmetuese, kurse në të dytin ajo është në mes të vargut dhe e lidh atributin me objektin e krahasuar. Edhe krahasimi me floririn nuk është i ri. Ky krahasim pason në vargun e katërt të këngës: „Zbardhon në mes të kopesë, / si floriri hazinesë”.³⁷ Nga ky krahasim hetojmë një mosshkëputje nga ambienti rural, nga kopeja, në mesin e së cilës ajo zbardhon. Krahasimi *si flori* e ndërlihdh relacionin poetik bejkëkopé. Rrafshi krahasues është real tokësor. Si xhevahiri ashtu edhe floriri janë objekte që e bëjnë krahasimin e vashës sa më me plotësi. Ata e shprehin bukurinë e saj, që është e rrallë dhe e çmueshme. Ajo është një bukuri e pashoqe, andaj guri i çmueshëm paraqet masën barazuese dhe krahasuese të bukurisë së saj shpirtërore dhe fizike. Në këngën e Hahnit ajo është: „E bardha si qehribari”.³⁸ Bardhësia dhe bukuria janë vënë në spikamë krahas njëra-tjetrës, dhe mu kjo bardhësi është shprehje e shijes për të bukurën, e krahasuar me shkëlqimin e *qehribarit*.

Janë raste interesante për t'u vënë në pah ato krahasime me mjete të kursyera, ku s'kemi as xhevahirë, as lira e as flornj. Mjetet krahasuese janë ndër ato më të thjeshtat. Ja, bie fjala, në një këngë arbëreshe, bardhësia e vashës krahasohet, me *bumbakun*, pra me pambukun: „Mor'je e bardhë si bumbak' / Qasu të të puth ndë bark”.³⁹ Nëse këtë mjet krahasues e konsiderojmë si tepër të thjeshtë dhe të varfër për zgjimin e asociacioneve erotike dhe poetike krijimin poetik në këtë këngë nuk duhet konsideruar të këtillë. Kjo nuk do të thotë varfëri poetike, përkundrazi, në këtë mënyrë vargu i afrohet më së shumti rrafshit real të jetës, nga ka buruar, por pakëz i varfër del sa i përket imagjinatës krijuese. Konkretisht, në këtë këngë krahasimi duket funksional aq sa është edhe i thjeshtë, por në anën tjetër bëhet edhe më funksional kur e shpalos pamjen poetike, kur djali i lutet vashës që t'i afrohet... Ndërkaq, mund të pohojmë se edhe me mjetet që duken të varfëra, mund të krijohen tablo tërheqëse poetike, në të cilat funksioni i krahasimit si figurë poetike është i rëndësishëm. Pra, nuk ka mjete të varfëra poetike e as figura të varfëra, por ka varfëri vetëm në mjeshtërinë poetike, nëse kjo është nën nivelin krijues dhe nën nivelin e mundësive.

Në këngën e Lugut të Gucisë asaj i drejtohet djali: „Moj e' mirë e hollë si toja”.⁴⁰ Krahasimi nuk paraqet ndonjë graciozitet të theksuar të një bukurie të spikatur, por e kryen funksionin e

³⁷ IF, 250 KPD, f. 154, k. 250, v. 3 e 4.

³⁸ Johan G. v. Hahn, *Albanesische Studien*, Jena 1854; në: MHFSH, I, f. 62, k. 3, v. 2.

³⁹ *Visaret*, IV, f. 352, k. 7, v. 2 e 3.

⁴⁰ Idriz Ulaj, *Këngë popullore nga Gucia*. Botim i autorit, Prishtinë 1978, f. 35, k. 75, v. 1.

hapjes së dialogut, të cilin vasha e vazhdon me t'ëmën, e kjo u jep ndjenjave erotike teh shprehëse. Në një këngë tjetër, vashën që e do djali është: „syzeza porsi kupa”.⁴¹ Ky krahasim shpreh një gjendje shqetësuese emocionale dhe njëherazi duke filluar prej tij e tutje shqetësimi vjen e rritet nëpër vargjet pasuese. Pra, krahasimi është shpalus i pamjes së gjendjes dhe i betimit të djalit për *syzezën porsi kupa*.

Në këngën arbëreshe vasha i jep zemër vetvetes: „Duro zëmër e duro, / sa duroi mali me borë”.⁴² Vasha e merr me të mirë vetveten, por edhe qan me lot për trimin, e lotët e saj pikojnë nga sytë si nga streha e *çatisë*. Të durosh sa *mali me borë* është një krahasim fort i rëndësishëm, me poentë morale tejet pozitive. Nuk qëndron nota optimiste në këtë varg vetëm në atë se ajo i jep vetes, se pas së keqes vjen e mira, por ky është një optimizëm i fshehur se durimi nuk do të jetë i gjatë. Do të jetë i gjatë aq sa rron edhe bora në mal, deri në stinën e verës, ndoshta, bora e zë borën... Ky do të jetë caku i porosisë se të keqen e zëvendëson e mira, sikurse borën e ftohtë — bari i gjelbër i pranverës që mbin pas saj. Në të kundërtën, të durojë ajo siç duron ndonjë mal i lartë borën tërë vitin, do të thotë ta pranosh luftën me një të keqe që s'ka të sosur. Por, megjithatë, duhet të luftosh me të keqen e jetës pa u hamendur, është kjo porosi e vargut, prandaj si i tillë, ky krahasim duket se ka një poentë aq të fuqishme morale sa hyn në radhën e më të mirëve në lirikën tonë popullore.

Si zakonisht, kënga e djalit për vashën nuk ka fund. Ai asaj i këndon prore, e sidomos veçoritë karakteristike trupore, e në anën tjetër e shpreh shijen e vet estete për të bukurën. E nëse kjo shije estete i afrohet rrafshit real, atëherë si e tillë duket shumë më e afërt ndjenjave, zgjon asociacione të menjëhershme erotike, si kjo këngë e Mitkos: „Moj e holla, si fisheku, / Cicat s'ti nxë jeleku. / Moj e holla si gargija, / Të paska hije shamija”.⁴³ Krahasimet *si fisheku* dhe *si gargija* janë të ndërtuara me shije për vashën truphollë, se mu kjo veçori e shquan bukurinë e saj tërheqëse, dhe kjo shije për të bukurën i afrohet shumë suptilitetit dhe erotizmit kulminant. Vashës i ka hije shamia, por bukurinë e saj e shquajnë në veçanti gjinjte nën jelek. Vargu i pestë, i cili është ndërtuar me anë të krahasimit, është paraprijës dhe shpalues i pamjes poetike në vargun e gjashtë; pra, jo formalisht sa për rimim, por për të shprehur plotësinë e tablosë poetike. Këta të dy shprehin thelbësisht një harmoni të përmbajtjes, e cila nuk i përgjigjet sa duhet vetë bukurisë harmonike. Pra, vasha

⁴¹ I F, KPD, Tiranë 1965, f. 5, v. 1.

⁴² Ziaudin Kodra, *Poezija popullore arbëreshe*, Ndërmarrja e botimeve, Tiranë 1957, f. 87, v. 1 e 2.

⁴³ Th. Mitko, BSH; në: MHFSH, II, f. 79, k. 8, v. 5—8.

është e hollë, ndërsa gjinjtë e saj nuk i zë jeleku! Këtu shfaqet si në antitezë kundërthënia e harmonisë trupore. Fisheku dhe gargia janë mjete të përshtatshme krahasuese për shprehjen e hollësisë trupore të vashës, të cilën këtu e shquajnë gjinjtë dhe shamia, e sidomos të parët. Sidoqoftë, tabloja poetike e krijuar prej këtyre vargjeve është e plotë. Aty dominon dinamizmi i shprehjes dhe i ndjenjave, e ky dinamizëm ndihet edhe në zmadhimin e tensionit erotik, i cili shpreh një gjendje reale emocionuese të djalit për vashën.

„Kah po m'shkon si kerr me sanë”⁴⁴ është krahasim i grandiozitetit trupor, por kerri duket se nuk është i mjaftueshëm pa genë i ngarkuar edhe me sanë!, mirëpo, është ky një krahasim i ndërtuar mbi një rrafsh që kalon më tepër kah zgjedhja e mjeteve jo të zakonshme, por të përditshme. Nga ky grandiozitet i pamjes poetike të vashës del njëherazi edhe madhështia trupore e saj në ambientin rural fushor. Në lirikën tonë erotike nuk janë të rralla rastet kur për krahasimin e vashës ose për krahasimin e trupit të saj përdoren edhe mjete të atilla që i tejkalojnë rradhët e së mundshmes, e tejkalojnë rrafshin real dhe i afrohen shprehjes hiperbolike: „Kur ec goca dridhet fusha, / dridhet fusha, dridhet toka, / si me qen karroc me topa”.⁴⁵ Krahasimi në vargun e dhjetë të kësaj kënge është mjaft simptomatik, sepse vasha është krahasuar me *karrocën me topa!* Pas këtij krahasimi, aty për aty, ne na shpaloset vizuelisht pamja e peshës së madhe trupore të gocës, e ajo duhet të jetë shtatgjatë, vithegjerë, shumë e shëndetshme, por mbi të gjitha mbi të do të mbizotërojë bukuria. Ajo bukuri duhet të jetë mahnitëse, por një gjendje e këtitllë e dëbon ndjenjën sublime, estete, të qetë dhe zgjon asociacionet e një bukurie të jashtëzakonshme, kur *dridhet fusha, dridhet toka* nga hapat e saj, por edhe nga vetë bukuria. Krahasimi është në nivelin e vargut paraprijës, ose nën të. Sidoqoftë, si është plotësim i dy vargjeve paraprijëse dhe deri diku e plotëson nevojën për një krahasim të qëlluar me gjendjen e krijuar nga ecja e gocës. Ambienti, në të cilin shpaloset kjo pamje poetike, është pa dyshim rural, por rural me shumë elemente të një ambienti kreshnik: *dridhja e fushës, dridhja e tokës* nga hapat e gocës, e aty është edhe *karroca me topa* për ta baraspeshuar këtë dridhje. Pa dyshim, e tërë përpjekja në ndërtimin e kësaj tabloje poetike është bërë për ta paraqitur bukurinë mahnitëse dhe të jashtëzakonshme të gocës. Pra, mjetet krahasuese nuk janë kursyer, kurse efekti i tyre duket i mjaftueshëm për parafytyrimin vizuel të bukurisë dhe të madhështisë.

⁴⁴ I A P, KPD, I, k. 98, v. 4.

⁴⁵ IF, 250 KPD, f. 49, v. 8—10.

Në vazhdimësi të këtij problemi të shtruar mund të përmendet edhe shembulli nga Ljarja, për vashën që po bëhet nuse: „Nusja e madhe si gjytet”.⁴⁶ Ky krahasim është fort interesant dhe mund të konsiderohet ndër figurat e rralla hiperbolike të këtij lloji ndër ne. Madhësia e asaj krahasohet me qytetin! Por, madhësia e qytetit nuk është barazuese as për afërsisht me madhësinë e vashës — nuse. Megjithëkëtë, nusja është e madhe. Në atë madhësi të hiperbolizuar, në kufijtë e pamundësisë, ka edhe hijeshi. Nusja, domosdo, është edhe e bukur, ndonëse kjo nuk përmendet, por nënkuptohet. Në ndërtimin e kësaj kënge krahasimi ka një funksion të caktuar ndërtues. Ai prin si varg fillues, dhe aty ku përfundon pjesa e parë e këngës ai përsëritet. Kënga është ndërtuar në dialog, e në këtë dialog merr pjesë edhe vasha — nusja. Krahasimi, si mjet shprehës poetik, këtu konsiderohet i zëvendësueshëm, por, kështu si është ndërtuar në këtë këngë, ai mund të radhitet pa hamendje në mesin e krahasimeve më të çuditshme në lirikën tonë popullore. Zgjimi i ndjenjave erotike duket i pakapshëm në këtë hapësirë tejet papërtheksuese. Gjasimi me disa krahasime të këngëve kreshnike duhet të përmendet domosdo. Ndikimet reciproke në poezinë popullore jo vetëm që janë të mundshme, por si të tilla janë gjithnjë të pranishme. Është e natyrshme që krahasimet e këtilla të mos e kenë burimin e tyre autokton në këngët lirike popullore, por përdorimi i tyre është fare i natyrshëm. Kjo është njëra prej shumë veçorive të përbashkëta të gjinive të poezisë popullore, sepse nuk ka kufij të prerë dhe të paprekshëm në mes të lirikës dhe epikës.

Ç. Rrafshi krahasues atmosferik

Moj e vogël porsi rrfeja

Atmosfera, me të reshurat e saj dhe shfaqjet e tjera në të, ka qenë prore e vrojtuar prej njeriut si ambient, ku ky ka bërë përpjekje të pandërprerë për ta realizuar qenien e vet njerëzore, duke u munduar që ta njohë më mirë. Në këngët lirike erotike nuk janë të rralla rastet e ndërtimit të figurës së krahasimit mbi ambientin atmosferik: shiun, boren, vesën, erën, shtrëngatën, furtunën, vapën, akullin, rrufenë, etj. . Djali i mahnitur i këndon bukurisë së vashës: „Shkon zorkadha qafëgjatë, / ka ergjënd, ka kollonatë, / djeg e përvëlon si vapë”.⁴⁷ Sorkadhja ka një bukuri që të bën për veti, të mbërthen me ankthin e bukurisë së vet, e pastaj të zë ky ankth e të djeg, të *përvëlon si vapë*. Kjo pjesë e pamjes poetike është ndërtuar me një mjeshtëri artistike për lak-

⁴⁶ Fran Jankaj, *Gjurmime albanologjike*, s. FE, I, 1971, f. 156, v. 1.

⁴⁷ IF, KPD, Tiranë 1965, f. 22, v. 2—4.

mi. Krahasimi është në funksion të plotë të ngritjes së tensionit erotik, të zgjimit të ndjenjave dhe të parafytyrimit vizuel të një bukurie të rrallë. Pozita e krahasimit, në relacion me metaforën dhe epitelin, nuk qëndron në varësi. Megjithëkëtë, këtu mund të vërehet një varësi reciproke, ndonëse vargu i dytë duket se është në funksion të krahasimit. Tabloja poetike zbulohet plotësisht në vargun e pestë „si vapë e gushtit më dogje”.⁴⁸ Fija transmetuese tani këtu prin në fillim të vargut dhe e kurorëzon përpjekjen e krijuesit popullor. Sukses i jashtëzakonshëm. Një varg të tillë do ta nënshkruante çdo poet i mirë. Poetika e këngës është fort e fuqishme, sepse nëpërmjet figurës së krahasimit krijohet një ambient sublin me emcione fort të fuqishme, të cilat i përjeton thellë djali për atë bukuri shumë tërheqëse të sosrkadhes, e cila e pushton të tërin, e tani e djeg dhe e përvëlon.

Në një këngë të Siarinës vasha është krahasuar me borën. Ajo është e bardhë si bora, por njëherazi është edhe e ftohtë mu si bora, sepse në lidhjet e saj me djalin është këputur diçka. Kjo këputje ka krijuar një det në mes të tyre. Mirëpo, djali prapë e do, e do bardhësinë e saj dhe e urren veten për një gabim të rëndë që bëri. Ai veten e dënon kështu: „Vrafsha veten si s'të mora!”.⁴⁹ Vasha tani nuk i takon atij; ajo bardhësi e bardhë si bora i takon tjetërkujt. Vasha është martuar, ndërsa djalit i mbetet mallkimi i vetvetes. Në mes të asaj bardhësie si bora dhe të vetëmallkimit ka diç që s'është thënë, diçka që nënkuptohet, e këtë e paralajmërojnë vargjet e para të këngës, por jo edhe ky varg i parë që prin: „Oj e mira bardh si bora”.⁵⁰ Djali, edhe pse qe afër vashës, prapë që të dy janë larg njëri-tjetrit. Ata kishin dikë në mes. Pengesa ishte e madhe. Ajo pengesë tani bëhet sa bjeshka ose sa deti dhe nuk kalohet dot. Bukuria e vashës, sa për ngushëllim, mbetet për djalin bardhësi si bora, por bardhësi që më shumë të ngrin në vend sesa të ngrohë.

Krahasimi, edhe pse i prin këngës, ai mbetet vetëm shpalues i pamjes poetike, ndërsa me anë të ngjyrës së bardhë, të identifikuar me objektin — borën, krijohet një gjendje e ngrirë e bukurisë së kristaltë që nuk zgjon kurrfarë ndjenjash të ngrohtësisë shpirtërore. Prandaj, estetja jo vetëm që largohet nga përjetimi, dikur dhe tani i dëshiruar dhe i parelizuar, por edhe krijon një gjendje psikologjike plot acar e ngricë në shpirtin e djalit. Pra, bardhësia nuk sjell gjithnjë ngrohtësi shpirtërore. E bardha dhe e zeza i janë kundërvënë gjithmonë njëra-tjetrës, ndërsa kësaj here e bardha mbetet e tillë, por njëherazi ajo e zbulon edhe anën tjetër të medaljes, e cila është çdo gjë tjetër, por e bardhë nuk është.

⁴⁸ *Po aty*, f. 22, v. 5.

⁴⁹ *Visaret*, III, f. 230, k. 20, v. 2.

⁵⁰ *Po aty*, f. 230, k. 20, v. 1.

Ky fenomen estetik-teorik është mjaft interesant. Bukuria estete dhe shija asgjë nuk humbin. Përkundrazi, kjo është një mjeshtëri e rrallë e vargut tonë popullor erotik; sepse nëpërmjet krahasimit të thjeshtë e të ndërtuar mbi një bazë shumë të fortë tradicionale, shpaloset një gjendje shpirtërore, një tablo poetike fort tërheqëse. Bukuria e vashës dhe bardhësia e saj *si bora*, në një rën anë, dashuria e parealizuar, në anën tjetër, janë paraqitur thjesht, por në këtë thjeshtësi reflektohet vetë bukuria e vashës dhe ajo e vargut. Shija estete për të bukurën është shfaqur nëpërmjet bardhësisë së borës. Pra, e bardha është ajo më e bukura, ajo më e mira e shoqeve, por ajo është një bukuri që ngroh dhe ngrin. Fundja, kjo është një antitezë e brendshme poetike që zë fill mu në vargun e parë të këngës — në figurën e krahasimit.

Për bukurinë mahnitëse të vashës, krahasimet shpesh përdoren të pakursyeshme, sa i përket objektit krahasues: „Porsi rrfeja shkon e vjen / Natë e ditë m'i bane terr”.⁵¹ Ajo është e vogël, por është fort e bukur. Bukuria e saj e pushton djalin, sepse kur ecën ajo, ec *si rrfeja*. Edhe kur shkon, prapë atypari kalon *si rrfeja*. Vetë bukuria e saj është rrufe. Ajo e sjell rrufenë, dhe lëshon kudo që kalon një dritë verbuese, e pastaj e ka radhën terri, errësira! Kjo pamje është një gradacion i mrekullueshëm në lirikën tonë erotike, i mbështetur në figurën e krahasimit. Është ky një ndërtim poetik i pashoq, ku pas territ pason helmi, e pastaj zemra e djalit helmohet nga ajo vashë *si rrufe*.

Ndërtimi i kësaj kënge është me interes për analizë, sepse në të prijnë tri krahasime njëri pas tjetrit, pos në vargun e parë, ashtu edhe në të dytin dhe në të tretin: „Moj e vogël porsi voca, / Shkon e vjen-o porsi rrfeja”.⁵² Krahasimi në vargun e tretë është përsëritje e të dytit, por i rindërtuar rishtazi, e, si i tillë, është mjaft tërheqës. Koloriti i tablosë poetike është ndërtuar me ngjyra të forta antitezash të brendshme të tablosë: ngjyra e së bardhës verbuese — si rrufe dhe terri i njëjtë si ditën ashtu edhe natën:

Vapa, bora dhe rrufeja, që të trija, në këngët e përmendura janë transponuar me një fuqi të jashtëzakonshme në tablotë e krijuara poetike. Figura e krahasimit në to ka një rol të rëndësishëm, se nëpërmjet tij zbulohet shija e hollë estete e popullit tonë, zbulohen ndjenjat dhe emocionet për përjetimin e së bukurës dhe njëherazi fuqia krijuese artistike e krijuesit tonë popullor paraqitet e lidhur ngushtë me fenomenet e natyrës.

⁵¹ Vinçenc Prenushi, *Visari Kombëtar. Këngë popullore gegënishte, I*, Sarajevë 1911, f. 126, k. 47, v. 3 e 4.

⁵² *Po aty*, f. 126, k. 47, v. 1 e 2.

D. Rrafshi krahasues kozmik

E bukur qi ndrit si dielli

Kozmosi gjithmonë për njeriun ka qenë një hapësirë reale që ekziston, por prore ka mbetur i largët në largësitë qiellore. E dëshira e njeriut prore ka mbetur e pashuar për atë bukuri përrallore, për ta shijuar për së afërmi atë botë të panjohur. Ndjenjat më të bukura, më të singerta, më njerëzore e më suptile shpirtërore ai i ka realizuar edhe në rrafshin kozmik. Në atë botë qiellore e ka lidhur realizimin e ndjenjave për të bukurën dhe shijen estete për bukurinë e vashës. Objektet qiellore prore i kanë shërbyer për krahasimin e saj. Madje, vërejmë se herë-herë vetëm një objekt nuk është i mjaftueshëm, andaj i gjejmë dy tok së bashku: hënën me diellin, ose hënën me yje, etj.. Kjo nuk do të thotë se aty ka varfëri në fuqinë e objektit krahasues, në relacion me atë që krahasohet, por kjo mund të jetë pa dyshim një ndjenjë e fuqishme e lirikës së botës subjektive, ku pangopshmëria për shfryerjen e ndjenjave erotike është shumë e madhe dhe sa të ekzistojë ajo ndjenjë, kemi bindjen, se shfryerja mbetet gati e njëjtë, ndërsa dinamizmi i shfaqjes së saj gjithnjë vjen e rritet.

Në një këngë të Mitkos, vasha është „Si hëna kur del me yje”.⁵³ Kështu djali i drejtohet vashës që po ia luan mendtë; i drejtohet asaj që e do aq shumë e nuk di si ta shprehë ndryshe madhështinë e bukurisë së saj. Madhështia e kësaj bukurie, veç mund të krahasohet me bukuritë jashtëtokësore, me atë bukuri që s'i përket njeriut dhe botës së tij. Djalit nuk i duket i mjaftë krahasimi i vashës me hënën. Hëna nuk i duket si vasha po të mos jenë aty edhe yjet. Hëna dhe yjet janë plotësim i njëri-tjetrit dhe kështu krijojnë një harmoni, që nga toka duket si një bukuri e përsosur. E mu kësaj bukurie ai dëshiron t'ia vë përballë vashën e tij, vashën që e do aq shumë. Atij i duket se vetëm ky nivel krahasimi është i mundshëm dhe i mjaftueshëm për bukurinë e asaj, pra, se vetëm hëna me yje janë të denja të krahasohen me të. Dallgët e shpirtit të djalit çohen peshë, mendtë i vlojnë. Atë e dëshiron aq shumë, sa këtij krahasimi në shqyrtim ia shton këtë varg pasues: „Ti m'i lojte mënt e mija”.⁵⁴ Nga krahasimi *si hëna kur del me yje* krijohet pamja poetike me një bukuri mahnitëse. Shija estete duket sheshazi se është fort e hollë dhe e shprehur me një suptilitet të rrallë. Si edhe në raste të tjera, edhe këtu, e bukura dëshirohet të përjetohet, por kjo aspak nuk ia ul vlerën shijes estete, përkundrazi ajo e forcon dhe e humanizon edhe më tej.

⁵³ Th. Mitko, DP; në: MHFSH, II, f. 205, k. 36, v. 3.

⁵⁴ *Po aty*, f. 205, k. 36 v. 4.

Në një këngë tjetër bukuria e vashës del: „Si hana qi shndrit në pyll”,⁵⁵ sepse ajo ka një hijeshi tokësore dhe jashtëtokësore, një bukuri që i gjason vetëm shndritjes së hënës në pyll. Fija transmetuese, si-ja tradicionale, prin në fillim të vargut. Rrafshi krahasues është, pra, jashtëtokësor — qiellor dhe zbret pastaj në tokë — në pyll, pra zbret andej nga është ngjitur kërkesa për gjetjen e objektit krahasues, ndërsa figura e krahasimit është më e plota në këtë pamje poetike. Pra, bukuria e vashës është si bukuria e shndritjes së hënës, e kjo zgjon asociacione të një bukurie të rrallë, e ngre nivelin e tensionit erotik duke e paraqitur bukurinë e saj si tejet sublime në perspektivën e parafytyrimit vizuel poetik.

Hëna, si objekt krahasues, është e shpeshtë dhe i takon rrafshit krahasues tradicional. Si e tillë, me bukurinë e saj, ajo do të jetë gjithnjë e pranishme në vargjet tona erotike popullore, sepse nga rrafshi kozmik ajo është objekt fort i përshtatshëm për krahasimin e bukurisë së vashës. Sidomos shndritja e saj është një bukuri e rrallë për ndërtimin e tablove poetike, për paraqitjen e bukurisë së jashtëzakonshme. Në këtë mënyrë jo vetëm që zgjohen ndjenjat më emocionuese, por ngrihet edhe tensioni poetik, i cili të duket se kësisoj arrin në pikën më të lartë. Një krahasim të ngjashëm e gjejmë edhe në këngën *A je brymë, a je borë*: „Si hana që shkrep në bahçe”.⁵⁶ Në këtë këngë të shkurtër dominon krahasimi i vashës në tërë këngën.

Dielli është objekt krahasues, po ashtu i shpeshtë, në vargun tonë erotik popullor. Në vargun e Hahnit ajo është „Than’ e kuqe ndë korie / Posi dieli kur bie”.⁵⁷ Ky është një krahasim fort i shpeshtë dhe i përsëritur. Rrafshi krahasues është tokësor, e pastaj ngrihet kah lartësitë qiellore, me tendenca rënieje përsëri kah toka. Ky digresion i ngritjes dhe i rënies është tradicional në lirikën tonë popullore dhe i jep një fuqi karakteristike shprehjes poetike, e fuqizon edhe më shumë tablonë, e mbarëson me elemente tokësore dhe qiellore, e mu ky shartim krijon një kolorit fort tërheqës.

Në një këngë tjetër të shënuar në *Dituria* e Selanikut, bukuria e vashës është një bukuri e rrallë. Ajo nuk është e zakonshme si të tjerat, e me çka të krahasohet pos me diellin që ndrit!: „E bukur qi ndritë si dielli”.⁵⁸ Si ndrit dielli, ashtu ndrit edhe vasha. Ajo ecën dhe bën dritë. Ecën vetëm malit, e bukurisë së saj i gëzohet më së shumti djali. Së paku kështu i duket atij, por asaj bukurie i gëzohet edhe kodra dhe *shtegu i malit*. Ky krahasim i heperbolizuar çel rrugë që mbi të të ndërtohen edhe vargjet e

⁵⁵ I F, KPD, Tir. 1965, f. 18, v. 7.

⁵⁶ A. Mustaqi, KPD, f. 57, v. 5.

⁵⁷ J. Hahn, AS; në: MHFSH, I, f. 66, k. 17, v. 1 e 2.

⁵⁸ *Dituria*, Selanik 1909; në: MHFSH, III, f. 536, k. 3, v. 1.

tjera me një fuqi mahnitëse poetike, siç është, bie fjala, vargu i tretë i kësaj kënge: „Tuëj gzuë kodren, tuëj gzuë shtegun”.⁵⁹ Është ky një varg i fort i goditur dhe i qëlluar, por i ndërtuar mbi bazën e krahasimit në vargun e parë. Krahasimi i përmendur është pikëmbështetëse dhe strumbular i këngës, por që edhe vetë ngrihet mbi ato themele dhe bëhet jo veç varg fillues, por edhe qendror në këtë këngë të bukur kushtuar vashës.

Në një këngë tjetër të vjetër, dielli është po ashtu objekt krahasues për vashën grykë-ërgjënde: „Grykë-ërgjëndeja kur shkon / si dielli na veshtron, / lëshon shënj e na vërbon”!⁶⁰ Pra, edhe këtu kemi të bëjmë me rrafshin krahasues kozmik. Shija estete është mjaft e hollë dhe e gdhendur: shkëlqimi, drita e fortë dhe rrezet, me ngrohtësinë e tyre përvëluese, janë vetë ajo. Edhe vështrimi i saj është i qeshur; ai është optimizmi i vetë jetës. Mungesa e ngrysjes e zbukuron edhe më shumë këtë pamje poetike. Dinamizmi dhe gjallëria e bëjnë zgjimin e emocioneve dhe të ndjenjave erotike me një intensitet fort të fuqishëm. Tensioni erotik është kulminant. Këto tri vargje të analizuara janë një bukurie e rrallë, janë margaritarë të krijimtarisë popullore për vashën që *vështron si dielli* e që lëshon dritë dhe i verbon djemtë e rinj.

Pos hënës dhe diellit është i pranishëm edhe ylli ose yjet në ndërtimin e krahasimeve në këngët tona lirike. Bie fjala, në një këngë shkodrane djali ka një hall, sepse vashën e ka afër, por edhe shumë larg dhe s’ka mundësi që ta shohë dhe të takohet me të. Për bukurinë e saj flasin të gjithë. Djali e ka parë vashën dhe është mahnitur: „Ashtu dole si m’kan thánë / Porsi hylli me bajrak!”⁶¹ thotë ai. Por nuk është vetëm yll, si yjet e tjerë të rëndomtë, por një yll që dallohet prej të tjerëve, është ky *yll me bajrak*. Ai do ta krahasojë me diçka që do t’i përgjigjej bukurisë së saj mahnitëse, asaj bukurie që të bën për vete. Ai drejtohet kah objektet e gjithësisë dhe e ndan yllin për ta krahasuar vashën me të. Por, ai kërkon një yll të jashtëzakonshëm, jo si të tjerët. Një kërkim i tillë poetik është vetë ndjenja suptile dhe jashtëzakonisht e fuqishme e një tensioni erotik shumë të ngritur. Krahasimi për bukurinë e vashës, e krahasuar me yllin, megjithëkëtë paraqet një bukurie të qetë, të largët e të pakapshme, që papritmas vjen e bëhet shumë e afërt, me një fuqi fort dinamike dhe e shton intensitetin erotik, sidomos në krahasimin e vargut të 26-të, ku ajo krahasohet me *bishën e malit*. Me këtë kalim të papritur nga qetësia sublime qiellore në një ambient të vrazhdë bishash mali, pasqyrohet gjallëria dhe vitaliteti i jetës. Pra, në bukurinë e saj, sado që është e pranishme butësia e qetë, e kraha-

⁵⁹ *Po aty*, f. 536 3, v. 3.

⁶⁰ *Visaret*, III, f. 238, k. 37, v. 3, 6 e 7.

⁶¹ *Visaret*, IV, f. 222, k. 26, v. 7 e 8, ose: KPD, Tiranë 1965, f. 43, v. 7 e 8.

suar me objekte të gjithësisë, megjithëkëtë vrazhdësia i gjason vetë jetës në malet tona. Kjo gjë nuk ngjet në të gjitha këngët tona lirike erotike, sepse është e pamundshme të gjesh kudo larmi rrafshesh krahasuese, si në këtë këngë. Digresionet e ngri-tjes prej rrafshit tokësor kah ai qiellor dhe zbritja sërish në tokë e paraqet vetë digresionin e gjendjes shpirtërore dhe të shqetë-suar të djalit.

Në këngët e ndërtuara me objekte krahasuese vetëm të një rrafshi kozmik, por të ndërtuara mirë e me mjeshtëri, mund të paraqitet çdo gjë që i takon gjendjes shpirtërore dhe bukurisë fizike, pra edhe pa shartimin e krahasimit me rrafshet e ndry-shme krahasuese, të cilat gjithësesi janë të mirëseardhura dhe janë freskim i mjeshtërisë poetike në lirikën tonë popullore.

Kënga popullore shumë vështirë mund të merret me mend pa figurën e krahasimit, sidomos disa lloje të saj, e në veçanti lirika erotike, prandaj rëndësia e kësaj figure është tejet e madhe. Përgjithësisht, kënga dhe poezia, po edhe proza, kanë pasur dhe kanë nevojë për një figurë të këtillë. Fati i saj nuk mund të pa-rapërcaktohet dhe të bëhen aludime për të ardhmen se a do të zhvillohet edhe më tutje, apo ngadalë do t'i ngushtohet shtrirja dhe do të bëhet si zorrë qorre e letërsisë!

Figura e krahasimit për vashën në këngët tona popullore të dashurisë është një nga mjetet më të rëndësishme poetike për pasqyrimin e idealit shpirtëror, fizik dhe estetik, e sidomos për bukurinë fizike dhe shpirtërore të vashës, duke ngërthyer në vete simpatinë, sinqeritetin, afrimin, lutjen, virgjërinë, besën, gu-ximin, pritjen, pengesat, dështimin, mallkimin etj., e nëpërmjet këtyre jo vetëm që pasqyrohet aftësia krijuese dhe shija estete për të bukurën, por edhe veçoritë etnopsikoklogjike kombëtare.

Përfundimi

Ky punim është pjesë e një studimi për figurën e krahasimit në këngët popullore shqiptare të dashurisë, ndërsa për analizë janë marrë shembuj nga të gjitha krahinat e Veriut dhe të Jugut duke respektuar njëherazi parimin e shtrirjes gjeografike dhe pa-rimin e vazhdimësisë së pandërprerë historike gjithëkombëtare.

Letërsia jonë gojore është shumë e pasur me këngë të da-shurisë, ndërsa krahasimi është figurë me rëndësi të posaçme. Ai është shumë më i përhapur për vashën sesa për djalin, por rol dominant në shtrirje zënë krahasimet për pjesët e trupit të vashës, e sidomos për zonat erogjene.

Rrafshet krahasuese të ndërtimit janë të llojllojshme, por në epërsi qëndrojnë rrafshet krahasuese bimore, shpesore dhe kos-mike. Kur ndërtohet mbi rrafshin tokësor, ofron mundësi më të mëdha shprehëse, por bëhet jashtëzakonisht i fuqishëm mbi rra-

fshet e kombinuara tokë-qiell-tokë. Me interes janë krahasimet për vashën e ambientit epik, sepse shfaqin dhe tendenca afrimi me krahasimet e vargut epik. Në përgjithësi dominon tipi i krahasimit të ambientit rural. Paraqitet i ndërtuar edhe me elemente urbane, por pa u shkëputur nga tradita rurale. Dallohen lehtë format stereotipe të ndërtimit të tij, veçori kjo e pranishme edhe te krahasimet joerotike.

Krahasimet erotike janë mjet shprehës i ndjenjave, i afrimit, i përjetimit, i normave morale dhe etike, i intimës, i fisnikërimit të shpirtit, i çiltësisë njerëzore dhe i njerizimit. Ai është reflektues i utilitaires, herë sheshazi e herë tërthoraz, por rrallë e lëndon esteten dhe shijen për të bukurën. Ai bëhet edhe pasqyrues i shijes së hollë kombëtare për të bukurën, i idealit etik dhe estetik dhe i shfaqjes së bukurisë shpirtërore dhe fizike. Është edhe shprehës i lutjes së përvuajtur dhe i krenarisë epike.

Krahasimi e hap, e zbërthen, e plotëson ose e përmbyll tablonë poetike. Është prijës, fillues, shpalues, përfundues ose varg qendror në struktura të këngës. Është hapës i dialogut lirik dhe ngritës i tensionit erotik; provokues i rrjedhave dhe i situatave shqetësuese të përjetimit; zbulues i veçorive psikologjike dhe etnopsikologjike; zgjues i parafytyrimit vizuel të prerë, të jashtëzakonshëm, gradativ ose eksploziv; shprehës i koloritetit të kufizuar të ngjyrave. Nuk është në funksion të epsheve të shfrenuara e as rrënues i domethënies objektive.

Krahasimi për vashën ka veçori të përbashkëta me krahasimet e tjera lirike, por dallohet me veçoritë specifike të emocionalitetit dhe të përjetimit. Është figurë e gjallë që jeton në bashkëjetesë me figurat e tjera. Janë të pranishme edhe tendencat e modernizimit të pamjeve poetike në këngët e dashurisë, pra edhe te krahasimi për vashën e urbanizuar, por ambienti rural ende është shumë i fuqishëm dhe pikëmbështetja qendrore e kësaj figure.

Zymer Neziri

LA POETIQUE DE LA COMPARAISON EROTIQUE
POUR JEUNE FILLE DANS CHANSONS POPULAIRES ALBANAISES
D'AMOUR

Résumé

Cet ouvrage est une partie de l'étude faite sur la de comparaison dans les chansons populaires albanaises d'amour. Pour l'analyse' on s'est, servi des exemples de toutes les régions du Nord et du Sud en respectant à la fois le principe de l'extenstion géographique, et celui de la continuité ininterrompue historique de la nation entière.

Notre littérature orale abonde en chansons d'amour, tandis que la comparaison est une figure d'une importance particulière. Elle est plus vaste pour la jeune fille que pour le jeune homme, mais ce sont les comparaisons des parties du corps de la jeune fille, surtout les zones érogènes, qui présentent un rôle dominant de cette extension.

Le plan comparatif de construction est diversifiant, mais c'est le domaine comparatif des plantes des oiseaux et cosmique qui domine. Quand il est construit sur le plan terrestre, il offre de plus grandes possibilités expressives, devient extrêmement puissant sur les combinés terre-ciel-terre. Les comparaisons sur la jeune fille d'un milieu épique sont fort intéressantes car elles expriment des tendances de rapprochement avec les comparaisons d'une versée épique. C'est le type de la comparaison d'ambiance rurale qui domine en général. Il apparaît construit avec des éléments urbains, mais sans se détacher de la tradition rurale. On peut facilement distinguer les formes stéréotypées de sa construction qui est une caractéristique des comparaisons non érotiques aussi.

Les comparaisons érotiques sont un moyen expressif des sentiments, du rapprochement, des normes morales et éthiques, de l'intimité, de l'annoblissement de l'âme, de la sincérité humaine et de l'humanité. Elle est le reflet de l'utilitaire, tantôt d'une manière directe, tantôt indirecte, mais elle viole rarement l'esthétique et le goût du beau. Elle reflète le goût raffiné national pour le beau, l'idéal éthique et esthétique ainsi que l'expression et la manifestation de la beauté spirituelle et physique. Elle est aussi l'expression de la demande humble et de la fierté épique.

La comparaison ouvre, resoud, complète ou bien conclut le tableau poétique. Elle débute, commence, développe, conclut ou bien présente le vers central de la structure de la chanson. Elle entame le dialogue lyrique et relève la tension érotique; provoque les conséquences et les situations critiques des sentiments; découvre les traits psychologiques et ethnopsychologiques; veille sur l'imagination visuelle irrévocable, extraordinaire, graduelle ou explosive; exprime le coloris limité des couleurs. Elle n'est pas en fonction des voluptés, effrénées, ni destructeur d'une signification objective.

La comparaison sur la jeune fille a des traits communs avec les autres comparaisons lyriques, mais elle se distingue par les traits spécifiques de l'émotionnalité et de la ensibilité. C'est une vive figure qui coexiste avec les autres figures. Les tendances de moderniser les aspects poétiques dans les chansons d'amour sont présentes aussi chez la jeune fille urbanisée, mais l'ambiance rurale et toujours puissante et le point central de cette figure.

